

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

GJEBREA TRANSLATIONS SHPK

Sot, më 06.03.2024., Znj. Lisena Gjebrea, shtetase shqiptare, e bija e Apollon Gjebresë dhe e Gjenovefa Gjebresë, lindur në Lezhë, më 29.06.1975, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 037719417 me nr. personal H55629106J, ka vendosur të themelojë dhe të nënshkruajë aktin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të kryejë aktivitetet në përputhje me ligjin nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe do të rregullohet nga ligji në fuqi dhe Statuti i saj, bashkëlidhur.

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Shoqëria me emrin Gjebrea Translations Sh.p.k. (më poshtë quajtur “Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.2 Emri tregtar i Shoqërisë është i njëjtë me emrin: Gjebrea Translations SHPK.

Neni 2


Zyra qendrore

- 2.1 Zyra qendrore e Shoqërisë është në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Faik Konica”, Pallati “Otto-AL”, Shkalla 1, Apt. 3/2, Tiranë, Republika e Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria mund të hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitetet në vende të tjera si brenda, ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit kompetent ose vendimmarrës.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekt i aktivitetit të Shoqërisë është:
 - (i) shërbime përkthimi, këshillim dhe asistencë në çështje gjuhësore të përkthimit dhe të organizimit të nevojshëm për funksionimin e shërbimit ndaj klientëve;
 - (ii) përditësim, analizë në lidhje me çështje teknike profesionale në fushën e përkthimit;
 - (ii) si edhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me sa cituar më sipër.



- 3.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakja e Shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i përfaqësuar në 1 (një) kuotë.
- 5.2 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer në para nga ortakja e vetme e Shoqërisë.
- 5.3 Ortake e Vetme e Shoqërisë është:

- **Znj. Lisena Gjebrea**, shtetase shqiptare, e bija e Apollon dhe Gjenovefa Gjebresë, lindur në Lezhë, më 29.06.1975, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 037719417 me nr. personal H55629106J, zotëruese e 100% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të barabarte me 100,000 (njëqindmijë) Lekë.

Neni 6

Organet e Shoqërisë

- 6.1 Organet e Shoqërisë janë:
- (i) Ortakja e Vetme;
 - (ii) Administratori/ët

Neni 7

Ortake e Vetme

- 7.1 Ortakja e Vetme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe i merr vendimet me shkrim dhe i regjistron në librin e vendimeve.
- 7.2 Vendimet e marra nga Ortakja e Vetme, në përputhje me ligjin janë të detyrueshme për Shoqërinë.



- 7.3 Ortakja e Vetme merr vendime në rastet e parashikuara nga ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në ligje të tjera si edhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

Neni 8


Kompetencat e Ortakes së Vetme

- 8.1 Ortakja e Vetme është kompetente për të vendosur për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve dhe vendos për shpërblimin e tij/tyre;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe vendos për shpërblimin e tyre;
 - e) mbikyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
 - j) shpërndarjen e fitimeve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, në rast të më shumë se një ortaku;
 - m) si edhe çështje të tjera të caktuara nga ligji ose nga statuti i shoqërisë.

Neni 9

Administratorët

- 9.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, persona fizikë të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Ortakja e Vetme.
- 9.2 Administratorët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe mund të riemërohen.
- 9.3 Administratore e parë e Shoqërisë është:




Znj. Lisena Gjebrea, shtetase shqiptare, e bija e Apollon dhe Gjenovefa Gjebresë, lindur në Lezhë, më 29.06.1975, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 037719417 dhe nr. personal H55629106J.

Neni 10

Kompetencat e Administratorëve

- 10.1 Administratorët janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e statutit ose ligjit të zbatueshëm.
- 10.2 Administratorët kanë të gjitha kompetencat e zakonshme për administrimin e veprimtarisë së përditshme të zakonshme të Shoqërisë, sipas parashikimit ligjor, përveç atyre, që sipas statutit ose ligjit të zbatueshëm, i takojnë Ortakut të Vetëm.
- 10.3 Në veçanti, Administratori gëzon kompetencat e listuara më poshtë:
 - (i) përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me palë të treta, publike ose private, të çdo lloj forme organizimi dhe niveli, duke përfshirë Autoritetin Tatimor, qendror ose vendor, Autoritetin Doganor, Zyra të tjera Regjistrimi të çdo lloji, Qendrën Kombëtare të Biznesit, të Licensimit ose tjetër, Ministrinë, ente të tjera publike, në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;
 - (ii) përfaqësimin e Shoqërisë dhe nënshkrimin në emër dhe për llogari të Shoqërisë gjatë çdo procedure negociimi, memorandumit, interesi, akti, marrëveshjeje, kontrate, vendimi, kërkesë, ankese, formulari apo dokumenti tjetër të çfarëdo lloji, duke marrë përsipër angazhime pa ndonjë kufizim në lloj, subjekt ose vlerë, në emer dhe për llogari të Shoqërisë;
 - (iii) përfaqësimin e Shoqërisë përpara bankave të nivelit të dytë që funksionojnë në Republikën e Shqipërisë dhe/ose përpara institucioneve të tjera financiare, sipas rastit dhe nevojës së Shoqërisë;
 - (iv) përfaqësimin e Shoqërisë në përcaktimin e rregullave funksionale dhe organizative për çështje që lidhen me aktivitetin e përditshëm ose jo të Shoqërisë, si për shembull, por pa u kufizuar vetëm në, hapjen e adresave dytësore, përfaqësimin në çështje tatimore, rimbursime ose kreditime ose pagesa, riorganizime, përfshirje, transferime, dhe çdo çështje tjetër të një natyre të ngjashme.



Neni 11

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 11.1 Eksperti kontabël i autorizuar emërohet me vendim të Ortakes së Vetme, sipas nenit 13 të këtij statuti, kur një emërim i tillë bëhet i detyrueshëm nga ligji në fuqi.

Neni 12

Viti Financiar

- 12.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 13


Fitimet

- 13.1 Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat e llogarive vjetore, me vendim të Ortakes së Vetme rezervohen ose u shpërndahen ortakëve të Shoqërisë.
- 13.2 Ortakja e Vetme mund të vendosë për krijimin e një rezerve të veçantë të Shoqërisë.

Nënshkruar në Tiranë, sot, më 06.03.2024.

ORTAKE E VETME

Nënshkrimi:

LISENA GJEBREA

Znj. Lisena Gjebrea